



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 85-të, të mbajtur më 12.04.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2226/1 të datës 17.06.2020, me pretendime për mosveprim të organeve kompetente të komunës /// sipas denoncimit për kryerjeje të aktiviteteve ndërtimore të Objektivit në mënyrë jo ligjore në /// në komunën ///, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent, sepse denoncimi përmban pretendime për të cilat KSHPK-ja tashmë ka vepruar në një rast me të njëjtin përshkrim faktik të pretendimeve si pretendimet në fjalë dhe është shqiptuar në lidhje me të njëjtën - ka marrë vendim në kompetencë të saj.

Lënda me numër 12-2226/1 të datës 17.06.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 17 qershor 2020, një parashtrues i panjohur ka bërë denoncim me pretendime për mosveprim nga organet kompetente të Komunës /// pas kallëzimit për aktivitete ndërtimi pa leje në një objekt prej /// në komunën ///, dhe është konstatuar rasti me numër 12-2226/1 nga 17 qershor 2020.

Në denoncim, parashtruesi thekson se udhëheqësia i ///, me në krye Sekretarin e Përgjithshëm ///, ka ndërmarrë veprime të paligjshme dhe ka kryer aktivitete ndërtimi pa leje dhe të paligjshme në një parcelë ndërtimore shtetërore që ndodhet në territorin e Komunës///, në m. shek. ///, PK ///, KK ///, Komuna///, në drejtim të ndërtimit të një magazine/qendër logjistike në ///.

Siç thuhet në denoncim, për ndërtimin e lokacionit të treguar, Komuna e /// ka lëshuar Leje për rikonstruksionin e një pjese të objektit për depo të kategorisë së dytë me numër /// të

///, por në lokacionin konkret janë kryer punë shtesë ndërtimore, kështu që objekti është ndërtuar në dy kate, pas së cilës në mënyrë të kundërligjshme, pa mbështetje adekuate ligjore, është riemëruar në hapësirë afariste.

Gjithashtu, parashtruesi thekson se në vitin 2016 në lokacionin në fjalë, udhëheqësia /// ka ndërmarrë veprime që synojnë kryerjen e paligjshme të aktiviteteve ndërtimore jashtë objektit të lejes së ndërtimit të lëshuar, gjë që parashtruesi dyshon se i ishte mundësuar nga kryetari i atëhershëm. ///.

Në denoncim thuhet se shërbimet kompetente komunale nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar aktivitetet, gjegjësisht për të sanksionuar kryerësit, edhe pse kundërligjshmëritë e përshkuara në disa raste gjatë vitit 2019 i janë njoftuar kryetarit të komunës /// // / Komuna dhe shërbimi i inspektoratit të ndërtimit pranë Komunës.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arrin në përfundimin se kërkesa përmban pretendime pas së cilës KSHPK-ja në lëndën me numër 12-5072 të vitit 2019, e cila përmban të njëjtat fakte të pretendimeve, tashmë ka vepruar dhe ka vendosur për to - në përputhje me kompetencat e saj në seancën e 51-të, ka marrë vendimin me numër 12-335/1, datë 21.09.2021, të publikuar në faqen e KSHPK-së. Nga aty, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Duke pasur parasysh të theksuarën e më sipërme, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

përpiloi: A.R.M.

miratoi: G.T., anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ**

**Kryetar,
Biljana Ivanovska**